UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 22. 12. 2003. GODINE

DHJETOR - DECEMBAR
2003

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të Konsiliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën prej 1 janar deri me 31 dhjetor 2004.

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о Годишњем консолидованом буџету Косова и његовом распореду за период од 1 јануара до 31 децембра 2004 год.

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on the annual consolidated budget of Kosovo, and the appropriations of time from January 1 up to December 31, 2004.

Sekretariati i Shërbimeve të Kuvendit - Ndërtesa e Kuvendit / Ndërtesa e Qeverisë - Rruga Nëna Tereze - Kosovë / Posta e UNMIK-ut
Секретаријат скупштинских служби - Скупштина Косова / зграда Владе - улица Мајке Терезе - Косово / Пошта УНМИК-а
Assembly Services Secretariat - Assembly of Kosovo / Government Building - Mother Theresa Street - Kosovo / UNMIK Post

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 DHJETOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës, e kryesoi Akademik **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit.

Bashkëkryesuese **Nafije Gaş**, anëtare e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 11,10.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mendoj se mund të fillojmë.

Mirëseardhje deputetëve në Seancën e radhës. Mirëseardhje deputetëve - ministra.

Të enjten e kaluar është caktuar vetëm një pikë e rendit të ditës dhe lidhur me këtë, materialet ju janë shpërndarë me kohë.

Prandaj, hap Seancën plenare.

Urdhëroni. E ka fjalën profesor Sabri Hamiti, në emër të LDK.

SABRI HAMITI:

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë i keni njoftimet që po organizohen dhe do të organizohen votime e zgjedhje për parlamentin e Serbisë në territorin e Kosovës. Kemi madje njoftime që kandidatë të zgjedhur për zgjedhjet në Serbi janë edhe disa anëtarë të Kuvendit të Kosovës, madje të Kryesisë së tij, si dhe anëtarë të Qeverisë.

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues i këtij vendi, duhet të marrë qëndrim lidhur me këto zhvillime të panatyrshme dhe politikisht të dëmshme për Kosovën.

Më së pari UNMIK-u dhe OSBE-a në Kosovë duhet të lirohen nga politika dyftyrëshe - hipokrite dhe të tregojnë se nuk mund të ketë zgjedhje politike të Beogradit në Kosovë. Arsyetimet e tyre të mëhershme: që nuk do të pengojnë as nuk do të trimërojnë këto zgjedhje - tash janë të papranueshme, meqë dihet se zgjedhjet e tilla krijojnë tensione në Kosovë, sidomos tensione politike ndërmjet etnive dhe përpiqen të paragjykojnë në mënyrë tinzare statusin politik të Kosovës.

Në anën tjetër, anëtarët e këtij Kuvendi nuk mund e nuk duhet të jenë kandidatë për zgjedhjet në Serbi. Si mund të jetë një njeri në organet përfaqësuese të dy vendeve në të njëjtën kohë?!

Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet një deklarate sot e këtu duhet të marrë qëndrim për këtë problematikë. Kuvendi i Kosovës, pra, duhet të kërkojë që zgjedhjet politike të Serbisë të mos organizohen në Kosovë, meqë Kosova është momentalisht nën administrimin e OKB. Kuvendi i Kosovës duhet t'i shpallë këto zgjedhje të paqena e të papranueshme dhe jam i sigurt që në diskutimin e kësaj çështjeje në këtë seancë dhe në përfundimet do të kemi përkrahjen e artikuluar edhe më parë të grupeve tjera parlamentare. Ju falënderoj.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Ismajl Kurteshi, në emër të PDK.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në seancën e fundit ka kërkuar nga Kuvendi dhe Kryesia e saj që të deklarohet në lidhje me zgjedhjet që do të organizohen më 28 dhjetor në Serbi dhe që UNMIK-u po i lejon që ato të shtrihen edhe në territorin e Kosovës.

Ne në mbledhjen e kaluar kemi folur më gjerësisht për dëmin që këto zgjedhje që lejohen edhe në Kosovë ia sjellin Kosovës. Prandja, kërkojmë që sot Kuvendi të dalë me këtë deklaratë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Po ashtu Grupi Parlamentar mbështetë që sot të hartohet një deklaratë e tillë ku do t'i shpallte ato zgjedhje si të pavlefshme për Kosovën dhe me efekte negative. Njëkohësisht Grupi ynë Parlamentar shprehë një shqetësim, pasi që kjo Seancë është e fundit për këtë vit dhe dihet Kuvendi i Kosovës patë marrë obligime që në fillim të vitit kur 42 deputetë të këtij Kuvendi inicuan një deklaratë për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran dhe më 10 shkurt fatmirësisht patëm dakordimin e

katër grupeve parlamentare që kjo çështje të finalizohet në një seancë solemne të këtij Kuvendi, por fatkeqësisht nuk u arrit gjatë këtij viti që të gjithë bartësit e institucioneve të kenë një gjuhë të përbashkët për këtë çështje dhe ne shprehim shqetësimin tonë se kjo çështje nuk duhet të përfundojë apo të finalizohet në prak apo gjatë fushatave elektorale, por fillimi i vitit të ardhshëm të na gjejë të harmonizuar për këtë çështje dhe ta avancojmë pozitën tonë, statusin tonë të Kosovës, sepse nuk mund të presim, sepse çdo pritje do të shkaktonte probleme dhe dilema për të ardhmen e Kosovës. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Dragisha Kërstoviq, në emër të «Povratakut».

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Poslanička grupa Koalicije «Povratak» je i na prošlom zasedanju izrazila svoje protivljenje za inicijative koje se danas ponavljaju u ovoj Skupštini. Dakle, Poslanička grupa Koalicije «Povratak» misli da ova Skupština nema taj kapacitet da može da se bavi pitanjem izbora koji se održavaju u Republici Srbiji a koje se odnose i na Kosovo «i Metohiju». Jednostavno to je pitanje kojim se bavi neko koji ima neki viši pravni kapacitet i mislim da će tim pitanjem... da se tim pitanjem bavi OSCE i neki drugi medjunarodno pravni subjekti a ti medjunarodni subjekti i OSCE s e d o d anas n isu i zjasnili o t ome d a izbori ne mogu da se za Republiku Srbiju.... ne mogu da se organizuju i na Kosovu «i Metohiji». Naprotiv, niko i slovima – n i k o od medjunarodno p ravnih subjekata n ije r ekao da t i izbori n e mogu d a s e organizuju na prostoru Kosova «i Metohije».

Za mene bi veća zabrinutost trebalo da bude i za ovu Skupštinu što Albanci sa juga Srbije abstiniraju i ne učestvuju na izborima koji su organizovani u Republici Srbiji. To je stvar za veću zabrinutost i mislim da bi možda o tome trebalo da se politički razgovara na mestima na kojima taj razgovor može da se organizuje.

Ja se u ime Poslaničke grupe Koalicije «Povratak» protivim da se ovo pitanje stavlja na dnevni red i imam utisak da je neki dogovor napravljen pre nego što je počelo zasedanje Skupštine da se ovo pitanje potegne i to će biti razlog da Poslanička grupa Koalicije «Povratak» u vezi s ovim zauzme poseban stav. Ako je ovo način da se Poslanička grupa Koalicije «Povratak» definitivno izbaci iz ove Skupštine - onda izvolite. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Dragishë të falemnderit shumë.

Vetëm një informatë para se të kalojmë në aprovimin e kësaj. Edhe oficielisht në Kryesi të Kuvendit ka ardhur kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Edhe në mbledhjen e kaluar, jam i informuar që është ngritur kjo çështje. Proceduralisht çdo gjë është në rregull. Çdo gjë është në rregull që të vendoset. Është kërkesë dhe asaj kërkese të Partisë Demokratike, ju e patë, iu kanë bashkëngjitur të gjithë. Në Kryesi kishim një debat shumë të mirë, një diskutim shumë të qëlluar dhe jemi unanimisht të një mendimi që Seanca plenare të aprovojë një deklaratë që e ka përgatitur Kryesia, të cilën do ta shihni, por pa u futur shumë në analiza dhe në debate.

Prandaj, vetëm t'i them Dragishës që marrëveshje gjithmonë në këtë Parlament paraprake ka me pasë, se e kërkon procedura demokratike. Jemi Parlament shumpartiak, jemi Parlament shumetnik dhe do të mundohemi bashkërisht.

Unë mendoj se ne do të bashkëngjitet Grupi "Kthimi" në punën e Parlamentit, sepse ka kontribuar vazhdimisht dy vite në punë të Kuvendit dhe duhet bashkërisht të punojmë e të kontribuojmë.

Prandaj, vazhdojmë me miratimin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse ka ndokush diçka për procesverbal, le të urdhërojë. Hilmo Kandiq, nëse e keni për Procesverbal, ju lutem urdhëro. Ndryshe jo.

Për atë u morëm vesh që futet pika e tretë e rendit të ditës – Deklarata e Kuvendit të Kosovës për çështjet që janë shtruar në rend dite, sepse tre-katër grupe parlamentare e kanë përkrahë. Kryesia e ka përkrahë dhe nuk ka debat për atë se a duhet futur në rend dite. E dij që e përkrahni Hilmo.

Tani kalojmë në Procesverbal, nëse ka ndokush, ose vërejtjet i jepni me shkrim sikur gjithmonë.

Tani kalojmë në shqyrtimin e pikës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin vjetor të konsoliduar të Kosovës dhe përvetësimet për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2004.

Për ta lehtësuar punën e vendimmarrjes – kolegë të rrespektuar deputetë, Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa e ekonomi, si komision referues, ju lutem – si Komision referues kanë bërë një rekomandim...

(Nga ky moment, deputetët e Koalicionit «Povratak» lëshojnë Seancën)

... një rekomandim të përgjithshëm sepse gati të gjitha komisionet e Parlamentit, për shkak të rëndësisë që ka dhe implikimeve të vetë buxhetit në jetën e vitit të ardhshëm - është e arsyeshme kanë qenë të shqetësuar dhe kanë punuar. Por, këto dy komisione, si komisione referuese, i kanë sintetizuar nën një dhe unë nuk do të lexoj gjatë sepse s'e kam n'iri me i lexue letrat e huaja gjatë.

Do t'i them vetëm propozimet e rekomandimeve që i kanë bërë, si vijon:

1. Komisionet, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për buxhet të vitit 2004 patën parasysh të gjitha amendamentet e propozuara, si dhe komentet e PSSP.

   Komisionet iu propozojnë deputetëve të Kuvendit të Kosovës që ta miratojnë Projektligjin për buxhetin e vitit 2004 me këto amendamente.

Pra, çështja duhet të fokusohet në amendamentet nga këto dy komisione, që janë komisione referuese.

Unë mendoj se është mënyra më e mirë dhe më rezultative është kjo.

Kalojmë menjëherë në:

Amendamentin 1, «Të zëvendësohet logoja e Projekligjit me logon e Kuvendit të Kosovës».

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Të zëvendësohet emërtimi i Projektligjit me këtë, në vijim: «Projektligji 2003/20 mbi aprovimin e buxhetit vjetor të Kosovës»...

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Në preambulën e Projektligjit riformulohet paragrafi 4 me këtë, në vijim: «Duke patur parasysh autoritetin e dhënë pjesës ekzekutive të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të dhëna nën bashkëngjitjen e dytë të Rregullores».

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime. Ju falemnderit.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4, Neni 1 të zëvendësohet si vijon: «...

Pasi e keni para veti, nuk do ta lexoj tekstin në vijim. A pajtoheni? Ju falemnderit.

Kush është për?

Hydajeti lajmërohet si anëtar i Kryesisë...

HYDAJET HYSENI:

Kam dy vërejtje, që mendoj duhet t'i kemi parasysh. E para – në amendamentin 4, si dhe në amendamentin 7 dhe në disa amendamente tjera, janë futur shumë ndryshime, që praktikisht përbëjnë shumë amendamente brenda një amendamenti.

Propozoj që ato të shqyrtohen si nënamendamente, por të votohet secili ndryshim veç e veç, sepse vërtetë po vëhemi në situatë absurde. Mund të jeshë për një ndryshim, por nuk je për të tjerat. Si do të votosh?

Prandaj, meqë janë bërë kështu, së paku të praktikohet, që do të thotë le të konsiderohen si një amendament të gjitha, por pikat e veçanta të konsiderohen si nënamendamente dhe të votohen veç e veç.

Dhe, e dyta. Po tërheq vërejtjen se, meqë ka edhe amendamente të komisioneve, që kësaj radhe së paku nuk na është shpërndarë materiali i përbashkët, ka mundësi që një amendament të nxjerrë pastaj prej funksioni – si të thuash – amendamente tjera që janë p ropozuar prej komisioneve. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Hydajet t'falemnderit. E dëgjuam, në mënyrë shumë demokratike propozimin e mendimin.

Kush është për amendamentin 4? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Dy abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, I keni materialet...

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon kush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush voton kundër? Askush nuk është kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A abstenon kush? Dy abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Dy abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A ka abstenenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon kush? Dy abstenime.

Kalon amendamenti.

Dhe, tani më lejoni një moment... Vetëm një moment t'i lexoj në vazhdim rekomandimet.

2. Komisionet i propzojnë Kuvendit të Kosovës që t'i miratojë edhe këto rekomandime.

Urdhëro, profesor. Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI:

Kam të drejtë edhe si deputet e në këtë rast po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe në emër të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar, po ashtu.

Ne mendojmë dhe propozojmë që në këto pika të rekomandimeve, madje e para të dalë një rekomandim, i cili thotë: – «Në pajtim me qëndrimin e Kryesisë dhe me rëndësinë e vëllimit të punës që ka Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar në vitin që do të hyjmë - të mbështetet financiarisht». Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Profesor të falemnderit shumë. Demokratikisht okej, proceduralisht jo, sepse s'e kanë shqyrtuar komisionet, prandaj më duhet të them që unë do të votoj kundër. Si procedurë.

Kjo ishte nën një. Nën dy, ju lutem dhe shiqoni. S'ka nevojë të polemizojmë. Desha pak edhe ta relaksojmë, do të thotë do ta vë në procedurë.

Nën një – vëhet në votim propozimi i komisioneve referuese – rekomandimi.

Kush është për atë? Ju falemnderit shumë.

A ka kush kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Prandaj, konsideroj se u aprovuan Rekomandimet dhe s'kemi arsye të votojmë për propozimin e dytë.

Po, po – në parim. Unë nuk e kontestova përmbajtjen e Grupit Parlamentar. Kjo do të vlejë për të gjitha komisionet dhe në veçanti ky komision me ia hapë bashkëpunimin ndërkombëtar komisioneve tjera sepse ka kërkesa - Komisioni për shërbime publike, që edhe sot e kishim; ka kërkesa Komisioni për gatishmëri emergjente, por do të ishte mirë që të punojnë bashkërisht komisionet dhe ju do ta keni përkrahjen, por jo dokumentativisht ashtu si e kërkuat, profesor.

Në qoftë se don të plotësosh diçka, urdhëro.

SABRI HAMITI:

Unë dua të sqaroj dy fjalë. Unë i dij procedurat fort mirë dhe e dij që edhe në këtë fazë kam të drejtë të shpreh mendimet e mia bash për secilin amendament, në mes tjerash edhe këtu, sidomos në pjesën që janë rekomandime, që e kanë kuptimin më të lirshëm të interpretimit.

Dhe, Grupi ynë Parlamentar, në mbledhje të vetë të rregullt, e ka studiuar dhe ka vendosë ta bëjë këtë propozim. Ky propozim mund të kalojë ose mos t'kalojë. Kjo është punë demokracie këtu. Vetëm se duhet të sqarohet kur të votohet. Sepse unë nuk besoj se janë kaq dyftyrsha dhe kaq t'pamençëm, bile anëtarët e LDK, që s'e dijnë çka po donë. Domethënë, është problemi i mënyrës se qysh votohet. Nëse ju thuhet votoni e zotoni, s'kanë arsye për 15 minuta me i ndërrue pikëpamjet. Përkundrazi, kjo është demokraci. Nëse s'fiton propozimi – iu bëftë mirë - Komisioni është i krejt Kuvendit. Ju falemnderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT:

Edhe në emër të PDK zoti Gani Koci, por ne e kryem votimin dhe i pranojmë krejt sqarimet e mëtutjeshme, me atë votën – një a sa ishte kundër... Urdhëro Gani.

GANI KOCI:

Ne tashmë e kemi votuar këtë ligj dhe ky është kofiri pas të vjelave që thonë, por propozimet që u dhanë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që të shqyrtohen edhe disa zgjidhje që janë ofruar si në emër të asaj që u thanë nënamendamente, unë dua të përmend vetëm një. Nuk dij, ose s'paku ata që më kanë mësuar mua, nuk ma kanë shpjeguar se cili është dallimi në mes rroges dhe pagës, ose çka nënkuptohet me rrogë dhe pagë, ndërsa kemi në amendamentin 4, në një paragraf këtu – «kategoritë e shpenzimeve nënkuptojnë rrogat dhe

pagat». Këto çështje dhe të tilla që do t'na përsëriten është mirë të na shpjegohen ose së paku me këto projektligje të mos bëjmë përpjekje që ne të ndryshojmë gjuhën të cilën e kemi mësuar deri tash çfarë është dhe si është.

Kjo zgjidhje «rroga» dhe «paga» për veti nuk e kuptoj çka është dhe çka është «rroga» dhe «paga». Ndoshta, Sabri Hamiti, më fal profesor mund t'na e shpjegoj ose profesoresha Salë në aspektin gjuhësor këtë. Por këtë e keni të miratuar tash në Projektligjin.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë do të doja përqëndrimin e vëmendjes tuaj. Ju falemnderit për kontributin.

Tani vendosim:

Kush është për aprovimin e Ligjit me ndryshimet e bëra me amendamente? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A ka abstenime? Tre abstenime.

Prandaj, konsideroj që është aprovuar Ligji dhe i uroj sukses Parlamentit sepse është Ligj që mundëson funksionalizimin e krejt jetës në Kosovë.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For .....Shumica – Vecina – Majority.....
- Kundër – Protiv – Against .....00.....
- Abstenime – Uzdržani – Abstaned.....03.....

(Duartrokitje)

Tani kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës. Kryesia e ka përpiluar një deklaratë. Unë mendoj se Kryesia është marrë vesh kush ta lexojë atë deklaratë të Kuvendit. Hydajet apo Fatmir urdhëroni.

FATMIR SEJDIU:

KUVENDI I KOSOVËS

Duke u mbështetur në Kornizën kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë, Kreu 1, neni 1.2 dhe neni 1.4; dhe Kreu 9, neni 1.26,

Kuvendi i Kosovës, në Seancën plenare, të mbajtur më 22 dhjetor 2003, miraton këtë

DEKLARATË

1. Kuvendi i Kosovës i deklaron jokushtetuese e të papranueshme Zgjedhjet e organizuara nga Serbia në territorin e Kosovës dhe provokim të rëndë për institucionet e Kosovës, qytetarët e saj dhe për institucionet ndërkombëtare në Kosovë;

2. Kuvendi i Kosovës, kërkon nga UNMIK-u që ta parandalojë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë të cilat paraqesin ndërhyrje flagrante në jetën institucionale të Kosovës dhe tensionojnë raportet e përgjithshme në Kosovë;

3. Kuvendi i Kosovës fton qytetarët e përkatësisë etnike serbe në Kosovë që të mos bëhen pre e manipulimeve dhe instrumentalizimeve negative politike të drejtuara jo vetëm kundër interesave të Kosovës por edhe interesave të vetë komunitetit serb në Kosovë.

Prishtinë, 22 dhjetor 2003.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit profesor.

Dëgjuam Deklaratën. Deklarata është përgatitur me shumë vëmendje. Vetëm një moment, ju lutem.

Besoj se 83 deputetë janë të pranishëm dhe gjithkush ndien nevojë për kontribut dhe kjo nuk mund ta përjashtojë asnjë. Unë kërkoj vëmendjen tuaj dhe po ju lus. Gjatë është biseduar dhe njëzërit prej anëtarëve të pranishëm kjo qasje - ky koncept - është përkrahur dhe ju lus të na përkrahni.

Prandaj:

- Kush është për këtë Deklaratë, ju lutem.

A ka votë kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka asnjë abstenim.

Prandaj konstatoj se 83 deputetë të pranishëm njëzërit e kanë aprovuar këtë Deklaratë. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:
- Për – Za – For .....Të gjithë – Svi – All.....
- Kundër – Protiv – Against .....00.....
- Abstenime – Uzdržani – Abstaned.....00.....

Me minuta - do të jetë orë akademike 45 minuta dhe e përfundoj. Ju falemnderit shumë për përkrahje njëvjeçare që i keni dhënë Parlamentit.

Unë besoj se 2004-shi do të jetë shumë më rezultativ dhe unë e Kryesia do t'ju përkrahim shumë më tepër se në 2003-shin.

Dhe, ju e dini – atë që unë e them, e mbaj gjithmonë. Ju falemnderit. Urime festat.

Por, edhe ministri e don fjalën.

ALI SADRIU:

Pikërisht është ajo që e kërkuat. Ne kemi projektu një koktej të mërkurën në ora 12 në Grand Hotel dhe, ju lutem – të gjithë jeni të ftuar.

Seanca përfundoi në orën 11,45.

E transkriptoi (1-19) RT/Zyra E-04, tel. 038-211-860